

Në kuadër të Ditës Botërore të Sindromës Dawn, Zyra e Këshillimit të Karrierës dhe Alumnit, në bashkëpunim me Njësinë Bazë të Metodologjisë së Mësimdhënies, zhvilluan aktivitetin me temë: "Të kuptojmë ndryshimin, të ndërtojmë përfshirjen".

Qëllimi i këtij aktiviteti ishte ndërgjegjësimi dhe informimi i studentëve për Sindromën Dawn, si dhe promovimi i të drejtave dhe nevojave të individëve me këtë sindromë, me synim për një jetë gjithëpërfshirëse si anëtarë të barabartë dhe të vlefshëm të shoqërisë dhe komunitetit ku jetojmë.

Gjithashtu aktiviteti pati për qëllim hulumtimin e njohurive dhe qëndrimeve të studentëve rreth Sindromës Dawn.

